



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

KOMITETI I
HELSINKIT
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
I REPUBLIKËS SË
MAQEDONË

RRJET

23

MES VEPRIMIT DHE MOSVEPRIMIT-

REFORMAT NË **KAPITULLIN 23**

Kjo pasqyrë e shkurtër i përmbledh të dhënat dhe rekomandimet kryesore të Raportit në hije për Kapitullin 23 për periudhën kohore nga maji 2016 deri në janar të vitit 2018. I hartuar nga Instituti për Politikë Evropiane – Shkup dhe Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Pasqyra përfshin tri periudha të ndryshme:

>>> periudha para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 11 dhjetor të vitit 2016,

>>> periudha e tranzicionit pas zgjedhjeve dhe para formimit të Qeverisë së re më datë 31 maj të vitit 2017, dhe

>>> periudha nga zgjedhja e Qeverisë së re deri në fund të muajit janar të vitit 2018.

Raporti i prezanton ngjarjet kryesore në periudhën e analizuar dhe jep rekomandime për politikën në secilën fushë të Kapitullit 23. Për analizë të detajuar të të gjitha fushave, ju lutemi shiheni Raportin në hije.

Recensente:

Dr. Malinka Ristevska - Jordanova

1. Gjyqësori

Gjyqësori në udhëkryq

Nevoja për reforma në sektorin gjyqësor ishte përcaktuar qartë në raportin e parë dhe të dytë të Grupit i Ekspertëve të Nivelit të Lartë i udhëhequr nga Pribe dhe Prioritetet e Reformave Urgjente të përpiluara nga Komisioni Evropian. Anketa e zbatuar, në kuadër të projektit "Rrjeti 23+",¹ e konfirmoi nevojën për reforma. Anketa tregon se 47 për qind e qytetarëve maqedonas konsiderojnë se gjendja në gjyqësor është e keqe.² Gjithashtu, gjyqësori, Prokuroria Publike, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë konsiderohen si institucione të cilat janë të varura, të njëanshme dhe joprofesionale.

Pas stagnimit dhe vendnumërimit të gjatë në këtë sferë, Qeveria e re filloi me aktivitete për zbatimin e reformave në fushën e gjyqësorit, të cilat u bënë pjesë e Planit 3-6-9.³ Strategjia për reforma në gjyqësor 2018-2022 u miratua përmes një procesi të gjerë dhe konsultativ. Ligji për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve u shfuqizua, ndërsa Ligji për Këshillin Gjyqësor u ndryshua për shkak të bartjes së kompetencave tek Këshilli Gjyqësor. Po ashtu, u përgatitën propozim ndryshimet e Ligjit për gjykata, Ligjit për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë dhe u publikuan në Regjistrin Elektronik Nacional të Legjislacionit (ENER) në janar të vitit 2018.

Pavarësia

Nivel jashtëzakonisht i ulët i pavarësisë së gjyqësorit nga ndikimet politike dhe ndikimet e tjera u vërejt në shumë raporte dhe analiza nga ana e organizatave të shoqërisë civile në kuadër të projektit "Rrjeti 23+", vazhdoi ta karakterizoj gjendjen e përgjithshme të gjyqësorit gjatë gjithë periudhës së raportimit.⁴

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë vazhduan t'i zgjedhin gjyqtarët dhe prokurorët publikë pa ndryshime të konsiderueshme të procesit zgjedhor. Zgjedhja e gjyqtarëve ishte objekt i diskutimit, prezantimit të shkurtër i CV të kandidatëve dhe pa arsyetim për (mos) zgjedhjen e kandidatëve me pikë më të lartë ose me numër të njëjtë të pikëve.⁵ Zgjedhja e gjyqtarëve në gjykatat më të larta u kritikua edhe në periudhën para formimit të Qeverisë së re në muajin shtator të vitit 2016 edhe gjatë zgjedhjes së fundit të gjyqtarëve nga ana e Këshillit Gjyqësor pas zgjedhjeve lokale në nëntor të vitit 2017. Disa gjyqtarë, të cilët aplikuan për këto pozicione, reagueshan për emërimet e fundit,⁶ veçanërisht për shkak të faktit se për herë të parë ishte anashkuar neni i Ligjit për gjykata, me ç'rast nuk ishte zgjedhur kandidati për gjyqtar në Gjykatën e Apelit në Shkup me numër më të madh të pikëve.

Kriteret për zgjedhjen dhe notimin e gjyqtarëve, të cilët për momentin bazohet ekskluzivisht mbi kriteret kuantitative për efikasitet, mbeten çështje problematike. Kriteret dallohen varësisht nga ligji: përderisa një ligj përcakton ekskluzivisht kriteret kuantitative, tjetri vendos kriteret etike, me çka krijohet hapësirë për manipulim. Problemi plotësues është mungesa e përgjegjësisë së Këshillit Gjyqësor dhe qasja e tij klienteliste. Sistemi aktual i avancimit të gjyqtarëve nuk i vendos në plan të parë ekspertizën dhe integritetin e tyre. Intervenimet në sistemin e notimit, avancimit dhe emërimit të gjyqtarëve gjatë viteve të kaluara rezultojnë me "derë të hapur" për ndikimet politike mbi gjyqësorin.⁷ Nga ana tjetër, anëtarët e Këshillit Gjyqësor vazhdimisht i potenconin përparësitë e sistemit, e që gjyqtarëve me rezultate më të mira u mundëson që "automatizisht" të jenë në radhët e para, ndonëse ka hapësirë për përmirësim.

Hapa të posaçëm ndaj fuqizimit të pavarësisë gjyqësore u ndërmorën me procesin e përgatitjes së ndryshimeve të Ligjit për gjykata dhe ndryshimeve të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.⁸ Hapat e mëparshëm kryesisht kishin të bënin me pjesën e bazave për përgjegjësi disiplinore, masat disiplinore dhe ndryshimet në kriteret për hyrje në gjyqësor. Kjo e fundit ka të bëjë me procedurën e përgjegjësisë disiplinore dhe notimit të gjyqtarëve, përmes inkorporimit të kriterëve kualitativë për notimin

1 "Rrjeti 23+", Anketa për Kapitullin 23, shkurt të vitit 2017, i aksesshëm në: <https://goo.gl/qyK85v>

2 More about the poll at http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazivanje-na-javno-mislenje-poglavje-23-kratka-verzija.pdf

3 Plani 3-6-9 i aksesshëm në internet faqen e Qeverisë së RM në linkun në vijim: <http://vlada.mk/sites/default/files/programa/2017-2020/Plan%203-6-9%20MKD.pdf>

4 Të gjitha analizat janë të aksesshme në: <http://www.merc.org.mk/>

5 Raporti i monitorimit të parë First monitoring report "Judiciary Reforms - from Priebe 1 to Priebe 2 and Beyond", faqe 5, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

6 Deklarata u dha në emisionin televiziv 360 shkallë: <http://360stepeni.mk/article/454/unapreduvanje-po-zasluzi-ili-po-nekoe-novo-tefterche>

7 Instituti për Politikë Evropiane, *Sitting on the bench and marking - how effective?*, 2018, i aksesshëm në: <https://goo.gl/ZaQxrE>

8 Ndryshimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor kanë filluar në fillim të gushtit të vitit 2017, përmes formimit të grupit të punës i angazhuar për këto ndryshime dhe hartimin e ligjit për ndërprerjen e vlefshmërisë së Ligjit për Këshillin për Përcaktimin e Fakteve dhe Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve. Shih më shumë në: <https://goo.gl/KPQrWX>

e gjyqtarëve. Megjithatë, disa organizata qytetare dhe ekspertë e vënë në dukje nevojën për specifikimin e mëturjes së bazave për përgjegjësinë e gjyqtarëve, si dhe kriteret kualitative për notimin e gjyqtarëve, të cilët fillimisht kanë të bëjnë me kompleksitetin e lëndëve, duke i marrë parasysh kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë, të përcaktuara me nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor gjatë notimit të gjyqtarëve. Gjithashtu, nevojitet në mënyrë plotësuese të përcaktohen kriteret për anëtarët e Këshillit Gjyqësor të cilët i zgjedh Kuvendi i RM-së, si dhe përkufizimi i nocionit "jurist i shquar". Nevojiten ndryshime ligjore sa i përket inkuorporimit të përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Komisioni i Venecias e dha opinionin e tij për draft-ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor nga viti 2017 në të cilin theksoi se "transparenca e rritur e procedurave para KGJ lidhur me çështjet e emërimit, në përgjithësi është zhvillim i mirëseardhur".⁹ Megjithatë, ai gjithashtu, vuri në dukje se është "e rëndësishme të sqarohen rregullat për rankimin e kandidatëve dhe si merret parasysh ky rankim në vendimin përfundimtar për emërimin e kandidatit."¹⁰

Në lidhje me zgjedhjen e prokurorëve publikë, ekziston mospërputhje të kushteve të cilat duhet t'i plotësoj Prokurori Publik i RM-së dhe Prokurori Publik i Prokurorisë më të Lartë Publike. Prej tyre nuk kërkohet të kenë përvojë si prokurorë publikë me rezultate të konfirmuara për punën e tyre.¹¹ Pas shkarkimit të Prokurorit Publik të RM-së, në muajin gusht të vitit 2017, në Parlament, më datë 25 dhjetor të vitit 2017, u zgjodh Prokurori i ri Publik i RM-së. Megjithatë, mbetet e paqartë se cilët kriterë janë marrë parasysh për zgjedhjen e tij, duke e pasur parasysh numrin e madh të kandidatëve për këtë vend, shoqëruar me transparencë të pa mjaftueshme të procedurës.

Këshilli Gjyqësor ndikoi drejtpërdrejtë mbi strukturën e gjyqtarëve të cilët vendosën për rastet e profilit më të lartë, të iniciuara nga ana e Prokurorisë Speciale Publike, përmes transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve nga gjykatat themelore në mbarë vendin në Gjykatën Themelore Shkup 1, si dhe transferimi i shtatë gjyqtarëve nga gjykatat e apelit në mbarë vendin deri te Gjykata e Apelit Shkup. Periudha raportuese u shënuar edhe me rishpërndarje masive të gjyqtarëve në Gjykatën Themelore Shkup 1.

E drejta e diskrecionit gjyqësor si garanci për pavarësi u shkel si pasojë e miratimit të Ligjit për vendimmarrje dhe përcaktim të lartësisë së dënimit. Ky ligj ishte kritikuar shpesh nga ana e ekspertëve, gjatë muajit korrik të vitit 2017, me qëllim të përcaktimit të ndikimit të këtij ligji mbi politikën e përgjithshme penale në vend.¹² Gjykata Kushtetuese vendosi ta anuloi ligjin, duke arsyetuar se me të seriozisht rrënohet pavarësia e gjyqësore dhe cenohet parimi i ndarjes së pushtetit, duke e përfshirë edhe ndërhyrjen e pushtetit ligjvënës në gjyqësor. Përveç kësaj, me vendimin theksohet se ligji është në kundërshtim me vlerësimin e lirë të përcaktuar në mënyrë ligjore të provave dhe të drejtës së diskrecionit gjyqësor, e që ishte formalizuar nga i njëjti, ndërsa nuk merret me individualizimin e dënimeve.¹³

Prokuroria Speciale Publike

Për dallim nga raporti për punën e saj në gjashtë muajt e parë,¹⁴ kur Prokuroria Speciale Publike (PSP) deklaroi se kompetenca është përcaktuar në 30 raste kundër 80 personave, raporti i tretë gjashtëmujor, i adresuar deri te Këshilli i Prokurorëve Publikë dhe Kuvendi i RM-së, deri më 15 mars të vitit 2017, thotë se PSP ka zbatuar procedurë para-hetimore kundër 112 personave, ndërsa 50 persona kanë qenë subjekt të procedurës hetimore. Gjithsej 272.950 audio regjistrime, përkatësisht 45 për qind nga numri i përgjithshëm i audio regjistrimeve, në dispozicion të PSP, ishin analizuar deri atëherë.¹⁵

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2017, PSP u pengua që tërësisht të vendos kompetencë dhe bashkëpunim të domosdoshëm me shumicën e institucioneve relevante shtetërore, siç është Ministria e Punëve të Brendshme, por ajo u ballafaqua edhe me obstrukcione në procedurat e Gjykatës Themelore Shkup 1. Ekziston një tendencë pozitive pas ndërrimit të pushtetit, në drejtim të tejkalimit të gjendjes paraprake dhe realizimit të bashkëpunimit më të mirë me PSP, veçanërisht sa i përket grumbullimit të provave dhe dokumenteve në përputhje me Ligjin për procedurë penale. Raporti i katërt, për punën e PSP nga data 15 mars deri më 15 shtator të vitit 2017, vë në dukje se dallimi nga periudhat paraprake është në paraqitjen e akuzave në lidhje me shumicën e procedurave të hapura hetimore, përkatësisht 18 akuza u paraqitën në 19 raste kundër 120 personave për 168 vepra penale, e që rezultoi me shtatë procedura hetimore kundër 25 personave dhe me veprime hetimore kundër katër personave juridikë.¹⁶

9 Komisioni Evropian për Demokraci përmes drejtësisë (Komisioni i Venecias). "Republika e Maqedonisë", Opinioni nr. 905 / 2017 on the Draft Law on the Judicial Council. I aksesshëm në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2017\)033-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2017)033-e)

10 Komisioni Evropian për Demokraci përmes drejtësisë (Komisioni i Venecias). "Republika e Maqedonisë", Opinioni nr. 905/2017 për Propozim-ligjin për Këshillin Gjyqësor. I aksesshëm në: [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2017\)033-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2017)033-e)

11 Ekzistojnë opinione të ekspertëve të cilët e theksojnë nevojën për ndryshimin e kësaj zgjidhjeje.

12 Nevoja për shfuqizimin e këtij ligji ishte vërejtur edhe në analizat e zbatuara në kuadër të projektit "Rrjeti 23+". Analiza e KPKDM është e aksesshme në: <https://goo.gl/iLYDe9> dhe analiza e Shoqatës Faktis, e aksesshme në: <https://goo.gl/bS3tNb>

13 Vendimi gjyqësor i aksesshëm në: <http://www.ustavensud.mk/domino/WEBSUD.nsf>

14 Raporti integral është i aksesshëm në: <https://goo.gl/d1kk5y>

15 Raporti i tretë i punës së PSP, i aksesshëm në: <http://www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/03/III-izvestaj.pdf/>

16 Raporti për aktivitetet e Prokurorisë Publike për Ndjekjen e Veprave Penale lidhur me dhe përmbajtjen e komunikimeve të gjetur të paligjshme për periudhën kohore prej gjashtë muajsh (15 mars 2017 deri më 15 shtator të vitit 2017). I aksesshëm në: www.jonsk.mk/wp-content/uploads/2017/09/III-BELSHATAJ-15.09.2017.pdf

Me qëllim të rregullimit të mëturjeshëm të statusit të zyrës së PSP, Strategjia për reforma në gjyqësor parashikon përfshirjen e PSP si prokurori e posaçme në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë me ndryshimin e ligjit për prokurorinë publike.¹⁷

Rekomandime

- Është i domosdoshëm fuqizimi i mëturjeshëm i pavarësisë së gjyqësorit duke e përfshirë edhe Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë, përmes një procesi përkatës dhe transparent dhe përmes vendimeve të justifikuara për emërimin dhe avancimin e gjyqtarëve, si dhe zbatimin e procedurave të qarta për zgjedhjen e kryetarëve të gjykatave dhe për transferimin e gjyqtarëve. Në këtë drejtim është edhe një pjesë e madhe e elementeve të Strategjisë për reforma në sektorin e jurisprudencës të cilat, mes tjerash, parashikojnë deprofesionalizim të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe përgjegjësi të tyre më të madhe. Deprofesionalizimi nuk është parashikuar në draft-ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor.
- Në drejtim të rritjes së pavarësisë së gjyqësorit janë edhe ndryshimet e propozuara ligjore të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Në mënyrë plotësuese nevojitet precizimi i profesionalizmit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht precizimi i kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të cilët zgjidhen nga Kuvendi i RM-së, si dhe përkufizimi i nocionit "jurist i shquar". Nevojiten edhe ndryshime ligjore në lidhje me inkorporimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor, përkatësisht të Këshillit të Prokurorëve Publikë.
- Sa i përket zgjedhjes së prokurorëve publikë është bërë diskrapancë të kushteve që duhet t'i plotësoj Prokurori Publik i RM-së dhe Prokurori Publik i Prokurorisë së Lartë Publike për të cilët nuk nevojitet të kenë stazh si prokurorë publikë me rezultate të konfirmuara gjatë punës.
- Edhe pse Këshilli i Prokurorëve Publikë ka miratuar Rregullore për notimin e prokurorëve publikë, sipas së cilës notimi bëhet çdo dy vjet, megjithatë, në praktikë notimi i këtillë i prokurorëve publikë nuk realizohet rregullisht dhe nuk jep rezultate përkatëse. Duhet të përmirësohet kualiteti i notimit të prokurorëve publikë. Në mënyrë plotësuese, duhet të bëhet precizimi i kriterëve të propozuara kualitative për notimin e gjyqtarëve, para së gjithash edhe varësisht nga kompleksiteti i lëndëve, si dhe të merren parasysh kriteret për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatë më të lartë të specifikuar në nenin 41 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor gjatë notimit të gjyqtarëve.
- Është i domosdoshëm fuqizimi i pavarësisë financiare në formën e përqindjes së rritur nga bruto prodhimi vendor, e që do të akordohej për gjyqësorin, në mënyrë që të arrihet përqindja e përcaktuar ligjore prej 0,8% nga BPV, e cila do të akordohej për pushtetin gjyqësor ose ndryshimi i kësaj dispozite në drejtim të akordimit të përqindjes optimale prej 0,5% nga BPV për financimin e gjyqësorit, konform analizave në këtë fushë. Në mënyrë plotësuese nevojitet të ndërpritet praktika që përmes rishikimit të buxhetit, të shkurtohet buxheti i pushtetit gjyqësor.
- Duhet të përshëndetet orientimi strategjik të cilin e përmban Strategjia për reforma në sektorin e jurisprudencës, për inkorporimin e PSP si prokurori e veçantë në kuadër të PPRM, e cila do të ishte kompetente për gjithë territorin e shtetit dhe përveç lëndëve të cilat rezultojnë nga ndjekja e pautorizuar e komunikimeve do të kishte edhe kompetencë të zgjeruar, në mënyrë që t'i përfshij edhe veprat e tjera penale të korrupsionit me profil të lartë (white-collar crime). Megjithatë, duhet të jemi shumë të kujdesshëm, me qëllim që të shmanget cilado qoftë mbivendosje e padëshiruar të kompetencave të saj me ato të PTHP për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Së këtejmi, mbetet sfida për garantimin e pavarësisë së plotë dhe paanshmërisë së gjyqtarëve të cilët do të zgjidhen që të veprojnë në atë seksion special, duke i pasur parasysh përvojat e deritanishme negative.

Paanshmëria

Veprimet etike dhe të paanshme nga ana e gjyqtarëve dhe kryetarëve të caktuar të gjykatave ishin nën dyshim serioz në kontekst të keqpërdorimit të mundshëm të sistemit informatikë për administrimin automatik të rasteve gjyqësore (AKMIS), veçanërisht sa i përket administrimit me rastet të cilat rezultojnë nga bisedat e përgjuara në kompetencë të PSP, të cilët u janë shpërndarë vetëm gjyqtarëve të caktuar të Gjykatës Themelore Shkup 1. Këto dyshime u theksuan në raportin e dytë të ekspertëve të Pribe.¹⁸ Duke e pasur parasysh se asnjëherë nuk është kryer kontroll i thellë i sistemit AKMIS, Grupi i Ekspertëve propozoi të bëhet një kontroll i këtillë pa kurrfarë ndërhyrjeje politike, dhe po qe se është e nevojshme, me përfshirjen e institucioneve dhe përfaqësuesve ndërkombëtarë. Në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë është formuar komisioni i posaçëm i cili do ta shqyrtoj keqpërdorimin e mundshëm të AKMIS. Pas përfundimit të këqyrjes për përcaktimin e funksionalitetit të sistemit informatikë dhe kontrollit mbi përdorimin e dispozitave të Rregullores së gjykatave në lidhje me AKMIS, në muajin janar të vitit 2018 u prezantua raporti përfundimtar,¹⁹ i cili iu adresua Prokurorisë Publike të RM-së për procedim të mëtutjeshëm.²⁰

Llogaridhënia

Duke e pasur parasysh se formimi i Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve (në tekstin në vijim: Këshilli i Fakteve) u vlerësua si i panevojshëm nga ana e ekspertëve edhe atë që në fillim, ndërsa më vonë u konfirmua përmes punës së tij, ndërkaq suspendimi i tij ishte përfshirë në Planin 3-6-9 dhe në Strategjinë për reforma në jurisprudencë.²¹ Në këtë kontekst, Kuvendi më 11 janar të vitit 2018 e miratoi Ligjin me të cilin u shfuqizua Ligji për Këshillin e Fakteve.²²

Si përgjigje ndaj kësaj, me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Këshillin Gjyqësor, nga muaji dhjetor i vitit 2017, Këshilli Gjyqësor sërish e mori kompetencën për administrimin me procedurën disiplinore, duke i pasur parasysh vërejtjet dhe rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare në pjesën e reformave gjyqësore. Ndryshimet, në lidhje me ngritjen e procedurës kundër gjyqtarëve të caktuar nga ana e Këshillit Gjyqësor, e përfshijnë edhe kërkesën që anëtarët e Këshillit, të cilët do ta fillojnë procedurën, të përjashtohen nga votimi për të njëjtën.

Rekomandime

- Vendimet e Këshillit Gjyqësor, përkatësisht Këshillit të Prokurorëve Publikë me të cilët përcaktohet përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi i gjyqtarëve, përkatësisht të prokurorëve publikë duhet të arsyetohen në mënyrë të qartë dhe në masë të kënaqshme.
- Në drejtim të rritjes së përgjegjësisë së gjyqësorit janë edhe ndryshimet e propozuara ligjore të Ligjit për gjykata dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor. Megjithatë, një pjesë e organizatave qytetare dhe publiku profesionistë janë të mendimit se nevojitet precizim plotësues të bazave për përgjegjësinë e gjyqtarëve.
- Nevojitet zbatim konsekuent të kodekseve etike të gjyqtarëve, prokurorëve dhe të punësuarve në prokuroritë publike. Në mënyrë plotësuese, gjyqtarët dhe prokurorët publikë duhet të përmbahen nga deklarata publike të cilat e vënë në pikëpyetje paanshmërinë e gjyqtarëve, përkatësisht të prokurorëve publikë.
- Heqja e imunitetit të gjyqtarëve duhet të jetë masë e nevojës së fundit e cila do të zbatohet në raste jashtëzakonisht të rralla.
- Duhet të sigurohet shpërndarje e paanshme e lëndëve (veçanërisht kur bëhet fjalë për raste penale sensitive të profilit të lartë) përmes garantimit të funksionimit papengësë të sistemit AKMIS. Nevojitet realizimi i kontrollit të rregullt dhe revizionit mbi funksionimin e tij, me qëllim që të parandalohen keqpërdorimet e çdo lloji të sistemit.

18 Vlerësimi dhe rekomandime nga Grupi Ekspert i Nivelit të Lartë për çështje që kanë të bëjnë me sundimin sistemor të të drejtës 2017, faqe 5

19 Shkarkuar më 30 janar të vitit 2018, <https://goo.gl/Jz398e>

20 Në mungesë të hetimit zyrtar, dyshimet për parregullsi dhe aktivitetet e paligjshme në funksionimin e Gjykatës Themelore Shkup 1 në kohën kryesimit të gjyqtarit Vladimir Pançevski, në mënyrë plotësuese u rritën pas kontrollit të zyrave të tij dhe shtëpisë së tij gjatë tetorit të vitit 2017 nga ana e ekipit të PSP, në kuadër të procedurës para-hetimore, në të cilën Pançevski dhe dy të punësuar në sektorin TI janë dyshuar për keqpërdorim të sistemit gjatë shpërndarjes së rasteve, veçanërisht të atyre të PSP. Shih: http://www.merc.org.mk/Files/Write/Documents/04801/mk/Mreza-23-mesecen-pregled-oktomvri-2017_MKD.pdf

21 Suspendimin e Këshillit për Përcaktimin e Fakteve dhe transferimin e kompetencave të tij tek Këshilli Gjyqësor e theksoi ministri i Drejtësisë, i aksesshëm në: <https://www.plusinfo.mk/vest/121365/na-sudskiot-sovet-kje-mu-se-vratat-site-nadleznosti>

22 Seanca e Kuvendit të RM, 11 janar të vitit 2018, <https://goo.gl/zm7nkp>

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë

Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPJ) në vazhdimësi e avancoi dhe modernizoi planin mësimor dhe cilësinë e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, edhe pse ka nevojë për përmirësim të mëturjes. Programi i projektuar kornizë, i cili mbështetet mbi evaluimin e trajnimeve shkëmbehet me gjykatat, Këshillin Gjyqësor dhe me Këshillin e Prokurorëve Publikë sa i përket vlerësimit të nevojave të mirëfillta për trajnim. Megjithatë, ekziston nevojja për përmirësimin e trajnimit.²³

Dy herë Këshilli Drejtues e ndryshoi Rregulloren për trajnimin fillestar në vitin 2017 në lidhje me mësimnxënien teorike, para se të zbatohet provimi përfundimtar për gjeneratën e gjashtë të kandidatëve.²⁴ Ndryshimet përkatëse e thjeshtëzuan sistemin e dhënies së pikëve dhe provimin përfundimtar. Publikimi i studimeve të rastit me pyetje të ofruara u zbatua në kundërshtim me Rregulloren. Zbatimi i provimeve elektronike akoma paraqet dyshim në lidhje me atë nëse me të vërtetë shërben për arritjen e qëllimeve të vlerësimit të aftësive praktike të kandidatëve.²⁵

Buxheti i AGJPJ për vitin 2017 ishte 41.125.000,00 denarë; megjithatë, pas rishikimit të buxhetit, në vend që të rritet buxheti u reduktua për 38.415.000,00 denarë, pavarësisht kërkesave të cilat rezultojnë nga implikimet financiare me ndryshimet ligjore në vitin 2015 dhe nevojës për përmirësimin e cilësisë së trajnimit dhe përmirësimin të objekteve teknike dhe infrastrukture.

Strategjia për reforma në sektorin gjyqësor nënkupton se duhet të përgatitet analizë për hartimin eventual të planit të veçantë mësimor për trajnimin fillestar për juristë me përvojë shumëvjeçare, duke përfshirë bashkëpunëtorë profesionistë me përvojë, si dhe trajnime të vazhdueshme përmes ndryshimeve të planeve mësimore dhe metodave mësimore. Në mënyrë plotësuese, Strategjia parashikon inkorporimin e kriterëve të reja ligjore në lidhje me përbërjen e organeve administrative dhe udhëheqëse të AGJPJ, si dhe ekipimi dhe mbindërtimi teknik dhe kushtet përkatëse hapësinore. Në përputhje me Strategjinë propozohen ndryshime ligjore, duke i pasur parasysh kriteret e reja ligjore në lidhje me përbërjen e organeve drejtuese dhe udhëheqëse të AGJPJ. Ndryshimet e këtilla luajnë rol kyç duke e pasur parasysh faktin që mandatet e anëtarëve të Këshillit Drejtues të AGJPJ dhe të drejtorit të AGJPJ tanimë kanë skaduar. Megjithatë, nevojiten ndryshime të mëturjes të ligjit, me qëllim që të parashikohen kriteret e caktuara të cilat duhet t'i përmbushin kandidatët.

Praktika Gjyqësore

Pas zvarritjes njëvjeçare, Gjykata Supreme e vuri në përdorim e-portalin gjyqësor <http://www.sud.mk/>, në të cilin duhet të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore. Në të vërtetë, portali praktikisht është jofunksional, përfshin vetëm një pjesë të vogël të vendimeve gjyqësore dhe nuk dihet nëse vendimet gjyqësore në dispozicion janë të zbatueshme, të modifikuara, të shfuqizuara ose anuluar. Hulumtimi i fundit në lidhje me publikimin e vendimeve gjyqësore dhe funksionalitetit të ueb-portalit sud.mk, në të cilin ishin përfshirë 224 juristë - të anketuar, tregoi se pjesa më e madhe e vendimeve gjyqësore nuk zbatohen në kohë.²⁶

Efikasiteti

Pas shumë prolongimeve, Raporti vjetor për punën e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitin 2016 u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen e mbajtur më datë 3 korrik të vitit 2017. Raporti përmban të dhëna për punën e Këshillit Gjyqësor, përkatësisht për numrin e gjyqtarëve dhe gjyqtarëve-porotë të përjashtuar, procedurat e ndërmarra për përcaktimin e punës joprofesionale, evaluimin e punës së gjyqtarëve, informacione në lidhje me veprimet e ndërmarra sipas ankesave të qytetarëve, si dhe të dhëna të tjera për punën e gjykatave në RM. Në lidhje me lëndët e prapambetura, pjesa më e madhe e rasteve më të vjetër se 7-10 vjet janë gjetur në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup, Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe në Gjykatën Themelore Kumanovë.²⁷

Sa i përket ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Komisioni ndër-sektorial për ekzekutimin e aktgjykimeve të GJEDNJ nuk është funksional, dhe nuk ka mbajtur mbledhje nga muaji mars i vitit 2016. Në praktikë nuk janë bërë ndërhyrje të rëndësishme në lidhje me dispozitat ligjore të cilat u specifikuan si burim i shkeljes së Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe as ndryshime të tjera të rëndësishme në praktikën gjyqësore dhe administrative. Ekzekutimi i aktgjykimeve të GJEDNJ kryesisht ka të bëjë me pagesën e kompensimit të përcaktuar në aktgjykime.

23 Raporti i parë për PRU në gjyqësor, është i aksesshëm në: <https://goo.gl/jpneR2>

24 <http://www.jpacademy.gov.mk/za-akademijata-mk/zakon-i-podzakoni-akti>

25 Raporti i dytë për PRU në gjyqësor, është i aksesshëm në: <https://goo.gl/osa2gD>

26 Për më shumë informacione, shih: Raporti i parë i monitorimit "Judicial Reforms - from Priebe 1 to Priebe 2 and beyond", faqe 8-9, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

27 Raporti i parë i monitorimi, faqe 8-9, i aksesshëm në: <https://goo.gl/Bqq7P6>

Rekomandime

- Duhet të bëhen ndryshime në Ligjin për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë në lidhje me kriteret për hyrjen e kandidatëve në trajnimin fillestar në AGJPP. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me kushtet për njohjen e gjuhës së huaj, si dhe me barazimin e kushteve për pranimin e dëgjuesve në trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, meqë me ndryshimet e Ligjit nga muaji dhjetor i vitit 2015 u bë një disbalanc midis zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.
- Është e domosdoshme analiza për krijimin e programit të ri për trajnim të veçantë fillestar për praktikientë me përvojë shumëvjeçare, si dhe për trajnimet e vazhdueshme përmes ridefinimit të programeve dhe metodave për realizimin e tyre. Me këtë do të përfshiheshin edhe bashkëpunëtorët profesionistë me përvojë si dhe praktikientët e tjerë me përvojë shumëvjeçare.
- Nevojitet të rritet buxheti i AGJPP, për shkak të implikimeve financiare të cilat i ofrojnë zgjidhjet ligjore nga viti 2015, si dhe për shkak të faktit se AGJPP çdo vit buxhetor futet në borxhe.
- Kohëzgjatja e stazhit në GJEDNJ të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nacional duhet të rritet për më së paku një vit, me qëllim që të fitojnë përvoja praktike të cilat do të mund t'i përvetësojnë.
- Nevojitet përmirësimi i funksionalitetit të portalit gjyqësor sud.mk, si dhe publikimi i aktgjykimi në portalin gjyqësor në afatin e përcaktuar me ligj, respektimi i udhëzimit për anonimizimin e aktgjykimeve si dhe të nënvizohet nëse të njëjtat janë të plotfuqishme ose jo.
- Nevojitet aktivitet i bashkërenditur i ministrit të Drejtësisë me organet kompetente shtetërore në drejtim të ekzekutimit më të mirë dhe më efikas të aktgjykimeve të GJEDNJ të miratuara sa i përket Republikës së Maqedonisë, ndërkaq duke e pasur parasysh monitorimin standard dhe/ose të përforcuar mbi implementimin e tyre të cilës të njëjtit i nënshtrohen nga ana e Komitetit të Ministrave pranë Këshillit të Evropës nga njëra anë, si dhe nevojës për shmangien e cenimeve individuale, si dhe ndryshimeve të legjislacionit dhe anulimit të praktikave negative sistemore të cilat janë në linjën e cenimit të të drejtave të njeriut, nga ana tjetër.

2. Lufta kundër korrupsionit

Krahas procedurave rrjedhëse të iniciuara nga PSP, lufta kundër korrupsionit mbetet në nivel shumë të ulët, e që manifestohet përmes mungesës së vazhdueshme të përgjegjesisë dhe mosndëshkimit të nëpunësve, shfrytëzimit joefikas të masës konfiskim dhe implementim të dobët të ligjit për denoncuesit, si dhe fakti që Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk i kryen në mënyrë të drejtë kompetencat e tij ligjore. Me pengimin e punës së PSP, organet kompetente shtetërore në të vërtetë e pamundësuan implementimin efikas të drejtësisë dhe i prolongonin rezultatet e pritshme konkrete nga lufta kundër korrupsionit.

Republika e Maqedonisë e shënoi rënien më të madhe të reputacionit të indeksit të perceptimit të korrupsionit.²⁸ Në vitin 2016,²⁹ Maqedonia u rankua në vendin e 90-të me 37 pikë, dhe shënoi rënie prej 24 vendeve në vitin 2015 kur u rankua në vendin e 66 në indeksin e perceptimit të korrupsionit. Përveç kësaj, anketa e zbatuar në kuadër të projektit "Rrjeti 23 +" dëshmoi se madje 60% e të anketuarve janë të mendimit se situata aktuale me luftën kundër korrupsionit është e keqe,³⁰ ndërsa 46% nga nëpunësit shtetërorë e dhanë vlerësimin e njëjtë.³¹ Ata konsiderojnë se kjo ka të bëjë me zbatimin jokonsistent, joobjektiv dhe selektiv të ligjit.

Sistemi Nacional i Integritetit (SNI), i zbatuar nga Transparencë Maqedoni, tregoi edhe pse Republika e Maqedonisë ka kornizë të mirë ligjore për luftë kundër korrupsionit, akoma ekziston implementimi i dobët i ligjeve anti-korrupsion, ndërsa institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit nuk administrohen në mënyrë efikase, madje nuk janë mjaftueshëm të pavarura për luftimin e korrupsionit dhe u mungon integriteti.³²

Nga ana tjetër, Republika e Maqedonisë akoma nuk ka ndërmarrë aktivitete për implementimin e një pjese të rekomandimeve të theksuara në Raportin e rrethit të katërt të evaluimit të Komitetit GREKO të Këshillit të Evropës, i cili u miratua më 6 dhjetor të vitit 2013. Raporti i GREKO për vlerësimin e implementimit nga 1 korriku të vitit 2016, i cili e trajton luftën kundër korrupsionit në Kuvend, gjyqësor dhe në Prokurorinë Publike,³³ konstatoi se vendi ka pasur implementim të kënaqshëm vetëm të tre nga gjithsej nëntëmbëdhjetë rekomandime, dhjetë janë pjesërisht të implemetnuara, ndërsa 6 nuk janë implementuar fare.

Katër nga rekomandimet e pa-implementuara të GREKO kanë të bëjnë me parandalimin e korrupsionit tek deputetët, ndërsa dy rekomandimet e tjera të pa-implementuara kanë të bëjnë me gjyqësorin dhe prokuroritë publike.³⁴ Si rezultat i kësaj, korrupsioni në gjyqësor është me rëndësi të veçantë. Edhe pse gjyqtarët, si edhe bartësit e tjerë të funksioneve shtetërore dhe publike, u nënshtrohen obligimeve të njëjta nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe Ligji për parandalimin e konfliktit të interesave, dhe ata e kanë për detyrë ta deklarojnë pronën e tyre. Ata, si edhe shumica e funksionarëve të tjerë, në përgjithësi e respektojnë obligimin për deklarimin e pronës së tyre, por në masë të madhe nuk i azhurnojnë fletë-anketat e tyre, ndërsa KSHPK akoma nuk ka inkorporuar mekanizëm për ndjekjen e ndryshimeve në pronën e gjyqtarëve.³⁵

Madje edhe pas ndryshimit të pushtetit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) u ballafaqua me sfida të konsiderueshme në lidhje me mos-kryerjen e kompetencave të veta ligjore, veçanërisht sa i përket përgjegjesisë, integritetit dhe transparencës dhe që rezultojnë në rolin e tij të parëndësishëm në luftën kundër korrupsionit. Puna e tij e përgjithshme mund të vlerësohet si pasive, selektive dhe pamjaftueshëm transparente. Për shembull, gjatë periudhës raportuese, Komisioni nuk ngriti asnjë procedurë me iniciativë të vet për çfarëdo lloj dyshimesh në lidhje me korrupsionin, dhe as që ngriti procedurë për përgjegjësi penale kundër personave të zgjedhur ose të emëruar, personave zyrtarë dhe personave përgjegjës në ndërmarrjet publike, institucionet publike dhe personave të tjerë juridikë me pronë shtetërore. Përveç kësaj, azhurnimi i Regjistrit të fletë-anketave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar mbetet njëra nga dobësitë kryesore të KSHPK. Nga ana tjetër, Komisioni është pasiv në lidhje me ngritjen e procedurave për monitorimin e punës financiare të partive politike. Kjo është shoqëruar me mangësi evidente dhe mangësi të kapacitetit të Prokurorisë Publike, ndërsa Enti Shtetëror i Revizionit mbetet shtylla më e fuqishme për luftë kundër korrupsionit.

28 Deklaratë e kryetarit të Transparenci Interneshënëll Maqedoni, e aksesshme në: <https://goo.gl/afxvng> [Accessed on 15.02.2017]

29 Indeksi i perceptimit të korrupsionit 2016, i aksesshëm në: https://www.transparency.org/news/feature/corruption_perceptions_index_2016

30 Rezultatet nga anketa janë të aksesshme në: http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/public_opinion_24_04_17/Istrazuvanje-na-javno-mislenje-poglavje-23-kratka-verzija.pdf

31 Rezultate nga anketa janë të aksesshme në: <http://www.merc.org.mk/Files/Write/00001/Files/Network23/Poglavje-23-Anketa-na-administracija.pdf>

32 Transparenci Interneshënëll Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet – Vlerësimi për Maqedoninë, maj 2006, f. 28, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf

33 Rrethi i katërt i evaluimit – Parandalimi i korrupsionit sa u përket deputetëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve, Raport për harmonizim "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë" (https://www.ecoi.net/file_upload/1226_1478595492_grecorc4-2016-8-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-en.pdf).

34 Ky vlerësim u shpreh edhe përmes komunikatës për media – Republika e Maqedonisë vazhdon të mos i respektoj rekomandimet e vlerësimit të katërt të GREKO, i cili e përfshin Kuvendin, gjyqësorin dhe Prokurorinë Publike, të publikuara më datë 22 dhjetor të vitit 2017. Ueb-faqja e Transparenci Interneshënëll, http://www.transparency.mk/index.php?option=com_content&task=view&id=1244&Itemid=57

35 Transparenci Interneshënëll Maqedoni, Sistemi Nacional për Integritet – Vlerësimi i Maqedonisë, maj 2006, f. 96, i aksesshëm në: http://www.transparency.mk/images/stories/NIS_mk.pdf;

Pastaj, nuk është arritur progres në fushën e konfiskimit të pronës së fituar në mënyrë të paligjshme, pa marrë parasysh procedurat e shumta të ngritura në rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, duke i përfshirë edhe rastet e PSP. Strategjia për fuqizimin e kapaciteteve në lidhje me zbatimin e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës, e miratuar nga Qeveria më 9 gusht të vitit 2017, pritet t'i përmirësoj kapacitetet dhe t'i tejkaloj mangësitë e identifikuara në këtë fushë.

Hap pozitiv i ndërmarrë me qëllim të mbrojtjes më efektive të denoncuesve ishte miratimi i Ligjit të ri për mbrojtjen e denoncuesve në tremujorin e fundit të periudhës raportuese, të cilës i parapriu debat i gjerë publik. Në të vërtetë ky Ligj mbulon një pjesë të madhe të opinioneve dhe rekomandimeve të Komisionit të Venecias, megjithatë zbatimi i tij do të ketë nevojë për ndryshime dhe plotësime plotësuese të më shumë akteve nënligjore, duke e përfshirë edhe Rregulloren për denoncimin e mbrojtur të brendshëm në sektorin publik,³⁶ si dhe harmonizimi i tij me nenin 50 të Ligjit për kontroll të brendshëm publik financiar.³⁷

Rekomandime

- Shteti doemos duhet të ndërmarr hapa serioz në drejtim të implementimit të plotë të **rekomandimeve të GRE-KO**, me theks të veçantë mbi rekomandimet që kanë të bëjnë me gjyqësorin.
- **Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit** përfundimisht dhe në mënyrë konsekuente duhet ta zbatoj Ligjin për parandalimin e korrupsionit në lidhje me fletë-anketat dhe ndryshimet e statusit pronësor të nëpunësve publikë, duke i përfshirë edhe anëtarët e tij, në përputhje me nenin 50-a të Ligjit për parandalimin e korrupsionit. Puna e KSHPK duhet të jetë publike si dhe arsyetimet e vendimeve të tij, veçanërisht vendimet që kanë të bëjnë me financimin politik, konfliktet e interesit dhe me fletë-anketat. Duhet të veproj në mënyrë të pavarur, proaktive dhe të paanshme, në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Njëherësh, është e domosdoshme të rritet transparencja e KSHPK përmes organizimit të sesioneve të hapura dhe publike dhe zhvillimit të bashkëpunimit të ngushtë me të gjitha organizatat e shoqërisë civile të cilat punojnë në fushën e luftës kundër korrupsionit edhe përkrah tendencës rrjedhëse të veprimeve të mbyllura dhe të izoluar, me ç'rast cenohet integriteti i këtij trupi.
- Nevojitet që Strategjia për fuqizimin e kapaciteteve për zbatimin e hetimeve financiare dhe **konfiskimin e pronës** të jetë komplementare me Strategjinë nacionale tanimë ekzistuese për luftë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit e miratuar për periudhën kohore 2017-2020 dhe dokumente të tjera strategjike. Organizatat joqeveritare në mënyrë aktive duhet ta ndjekin implementimin e Strategjisë.
- Ndryshimi ose plotësimi i Ligjit për **denoncues** është një hap pozitiv në drejtim të harmonizimit të tij me rekomandimet e Komisionit të Venecias, me qëllim që të evitohen të gjitha mangësitë e konstatuara në draft-ligjin ekzistues. Megjithatë, ky Ligj dhe aktet relevante nënligjore duhet të implementohen vazhdimisht, me ç'rast shteti do të duhet të bëjë përgatitje të konsiderueshme juridike, institucionale dhe praktike për zbatimin e ligjit, si dhe t'i ndërgjegjësoj qytetarët në lidhje me kornizën juridike, me qëllim që të sigurohet zbatimi efikas i saj.

36 Official Gazette of the Republic of Macedonia" No.46 / 2016.

37 Official Gazette of the Republic of Macedonia" No. 90/09, 12/11, 188/13, 192/15, 147/17.

3. Të drejtat themelore

Sjellja joadekuat e nëpunësve policorë edhe më tutje është çështje kryesore për të drejtat e njeriut, duke e pasur parasysh jofikasitetin e Sektorit për Kontroll të Brendshëm, standarde profesionale dhe hetime penale në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe mungesa e hetimit efikas nga ana e Prokurorisë Publike në rastet e torturës, trajtimit brutal, jonjerëzor, përçmues ose ndëshkues. Duhet të mbështeten angazhimet e Këshillit të Evropës, me qëllim që të vendoset mekanizëm mbikëqyrës, i jashtëm dhe i pavarur në lidhje me sjelljen e paligjshme policore dhe përdorimin e forcës së tepruar nga ana e policisë.³⁸ Në këtë kuptim, Kuvendi së shpejti do të diskutoj për një sërë ndryshimesh ligjore për sigurimin e kornizës juridike për vendosjen e këtij mekanizmi.

Veçanërisht shqetëson gjendja me personat e privuar nga liria në institucionet ndëshkuese-korrektuese në vend. Avokati i Popullit vazhdimisht e vë në dukje mbipopullimin e institucioneve, e që rezulton me kushte jo humane për personat e dënuar dhe personat e paraburgosur në burgje.³⁹

Asnjëri nga 11 aktgjykimet e miratuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me Maqedoninë, të cilat konstatojnë shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk është zbatuar plotësisht.

Diskriminimi në baza të ndryshme, duke e përfshirë edhe gjininë, seksin orientimin seksual, aftësinë e kufizuar, përkatësinë dhe bindjet politike e partiake, është shkelja më e evidente e të drejtave të njeriut e vërejtur nga organizatat vendase, duke e përfshirë edhe Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Kjo shoqërohet me mos-aktivitetin e Komisionit për anti-diskriminim, gjithashtu për shkak të mungesës së kompetencës nga ana e disa prej anëtarëve të tij. Përveç kësaj, ekziston diskriminim i gjerë ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBTI, si dhe mosndëshkim të kryerësve të sulmeve mbi qendrën për mbështetje të LGBTI, të cilët nuk u ballafaquan me drejtësinë vite të tëra pas incidenteve. Një hap pozitiv në këtë drejtim janë ndryshimet e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, me të cilin parashikohet përfshirja e orientimit seksual në bazat e diskriminimit, të cilin shumë organizata të shoqërisë civile e promovojnë vite me radhë.

Liria e shprehjes, në mënyrë plotësuese, u rrezikua përmes një sërë sulmesh mbi gazetarë dhe ekipe gazetareske, duke i penguar t'i kryejnë detyrat e tyre profesionale në interes publik. Përveç kësaj, gjuha e urrejtjes e pranishme në mediat elektronike dhe të shkruara, megjithatë e përforcuar në ueb-faqet e mediave sociale dhe në internet, si dhe gjatë kohës së protestave "Për një Maqedoni të lirë" rezultoi me një sërë të veprave nga urrejtja, e që kulmoi me ngjarjet në Kuvend më 27 prill të vitit 2017.

Liria e bashkimit u pengua me ndalimet, paraburgimet dhe me dënimet e konsiderueshme për aktivistët e shoqërisë civile për shkelje banale në kontekstin e të ashtuquajturit "Revolucion i laramantë" kur ata e shprehën pakënaqësinë e tyre nga autoritetet dhe kërkuan dorëheqje nga presidenti Ivanov pas vendimit të tij për abolicion kolektiv në pranverën e vitit 2016. Nga ana tjetër, më 28 nëntor të vitit 2017 u arrestuan 36 persona, për çka Avokati i Popullit shprehu shqetësim serioz sa i përket ligjshmërisë së arrestimit dhe paraburgimit të disa deputetëve nga aspekti i procedurave përkatëse ligjore që kanë të bëjnë me imunitetin e tyre.⁴⁰

Liria e bashkimit në mënyrë esenciale u pengua nga tentativat që t'ua mbyllin gojën organizatave të lira të shoqërisë civile përmes kontrollit intensiv financiar nga ana e Drejtorisë së të Ardhurave Publike, me urdhër të KSHPK nga muaji dhjetor i vitit 2016 deri në maj të vitit 2017, qëllimi i të cilëve ishin 22 organizata qytetare. Edhe pse nuk rezultuan me konstatim për keqpërdorim gjatë punës së tyre financiare, procedurat e ngritura para prokurorit publik zyrtarisht nuk janë mbyllur, e që e vë në pikëpyetje sigurinë e tyre juridike.⁴¹

Një kontrovers e madhe në publik u shkaktua edhe nga procedura parlamentare e iniciuar nga propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve e që në masë të konsiderueshme e zgjeron shtrirjen e përdorimit të gjuhës shqipe. Edhe krahas reagimeve, Qeveria vendosi ta miratoj shpejt këtë Ligj edhe pse bëhet fjalë për ligj me të cilin rregullohet një materie komplekse dhe sensitive.

38 Për më shumë informacione për projektet e Këshillit të Evropës në këtë aspekt, shih: <http://www.coe.int/en/web/criminal-law-coop/home-from-oversight> dhe <http://www.coe.int/en/web/skopje/enhancing-human-rights-policing>. Këto projekte parashikojnë miratimin e modelit "Prokurori plus", përfshirë edhe formimin e seksionit të posaçëm në Prokurorinë Publike për rastet e trajtimit joadekuat policor, formimin e trupit të posaçëm për mbikëqyrje të jashtme si trup i shkallës së dytë i këtij mekanizmi, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e organizatave qytetare dhe ekspertë të fushës.

39 Shih: Raporti vjetor për nivelin e respektimit, fuqizimit dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, 2016, i aksesshëm në: <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2016/GI-2016.pdf>, pages 51-55.

40 Materials on detention motions are available at <http://www.sobranie.mk/materialdetails.nsp?materialId=2f6ebb9c-af48-459f-8489-265b77153355>

41 Ky fakt u theksua nga ana e përfaqësuesve të një numri të madh të organizatave qytetare të cilat në mënyrë aktive morën pjesë në punën e fokus-grupit më 15 shtator të vitit 2017, me qëllim të përpilimit të këtij dokumenti.

- Kuvendi, duhet ta shqyrtoj me kujdes Raportin vjetor të **Avokatit të Popullit** dhe t'i identifikoj masat e zbatimit të rekomandimeve të përgjithshme për përmirësimin e sistemit në bazë të ndryshimeve ligjore. Në mënyrë plotësuese, duhet të sigurohet financim përkatës të zyrës së Avokatit të Popullit në mënyrë që të filloj me zbatimin e autorizimeve të përcaktuara dhe t'i shmangët çfarëdo lloji të implementimit pro-formë të rekomandimeve të dhëna nga ana e organizatave ndërkombëtare.
- Joaktiviteti dhe instrumentalizimi politik i **Gjykatës Kushtetuese** rezultoi me mangësi të vazhdueshme të kredibilitetit dhe besimit publik. Procesi i zgjedhjes së gjyqtarëve duhet të mbaj llogari për profesionalizmin, kompetencën dhe integritetin e gjyqtarëve të sapo zgjedhur, e që në fund duhet ta rris nivelin e Gjykatës Kushtetuese. Me qëllim që të rritet besimi publik në Gjykatën Kushtetuese, do të ishte e domosdoshme të përkufizohet nocioni "jurist i shquar". Përveç kësaj, kandidatët për gjyqtarë kushtetues, para se të emërohen, duhet të jenë objekt të diskutimit nga ana e komunitetit akademik, veçanërisht kur gjyqtarët emërohen nga ana e Kuvendit. Duhet të merret parasysh rritja e shumicës së nevojshme parlamentare për zgjedhjen e gjyqtarëve kushtetues. Në bazë të kornizës ekzistuese ligjore, zgjedhja bëhet me shumicë absolute, e që mund të rezultojë me zgjedhjen e gjyqtarëve gjatë mungesës së opozitës. Pastaj, duhet të inkorporohet ankesë kushtetuese që të sigurohet mbrojtje më e mirë e lirive dhe të drejtave të qytetarëve.
- Organet kompetente duhet të ndërpresin me mosndëshkimin e nëpunësve të autorizuar për **torturë dhe forma të tjera të trajtimit jonjerëzor dhe përcmues**. Aktiviteti i munguar i Prokurorisë Publike në rastet e torturës, veçanërisht kur e njëjta kryhet nga ana e nëpunësve policorë, në mënyrë plotësuese e përforcon mosbesimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor. Njëkohësisht, duhet të bëhen përpjekje serioze në lidhje me ekzekutimin e aktgjykimeve në të cilat Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka konstatuar shkelje të nenit 3, me hapjen e sërishme të lëndës kur është e mundur, dhe kur nuk ka ligj për kufizimin e ndjekjes penale. Inkorporimi i mekanizmit të jashtëm për monitorimin mbi punën e policisë dhe ndjekjen e rasteve të keqpërdorimit policor duhet të vihet në praktikë sa më shpejtë të jetë e mundur, përmes miratimit të kornizës së parashikuar ligjore dhe ndërtimit të kapaciteteve të nevojshme institucionale për zbatim konsekuent. Viktimat e torturës dhe trajtimi i keq i policisë duhet të garantohen me mbështetje përkatëse juridike, mjekësore, psikologjike dhe sociale, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Direktivën e BE 2012/29 për përcaktimin e standardeve minimale për drejtësi, mbështetje dhe mbrojtje të viktimave të veprave penale.
- **Kushtet në burgje, mbipopullimi dhe trajtimi i të burgosurve** janë alarmante. Nevojiten masa urgjente, me qëllim që të ndryshojnë politikat me të cilat rregullohet ekzekutimi i dënimeve dhe paraburgimi, si dhe implementimi i plotë i rekomandimeve të KPT për tejkalimin e mangësive të konstatuara, me vënien e theksin mbi përmirësimin e kushteve të përgjithshme, sigurimin e kujdesit përkatës mjekësor, parandalimin dhe përgjegjësinë në raste të veprimit të keq, si dhe parandalimit të korrupsionit. Me rëndësi thelbësore është zbardhja e rasteve të vdekjeve të të burgosurve në burgje. Mekanizmi Parandalues Nacional urgjentisht duhet të pajset me kuadër dhe resurse materiale dhe financiare, me qëllim që në mënyrë përkatëse të mund t'i kryej detyrat e tij. Organizatat joqeveritare duhet të kenë qasje të lirë deri te burgjet, për shkak të kontrolleve të rregullta të kushteve, me qëllim që të japin rekomandime në drejtim të përmirësimit të tyre. Ligji për amnisti duhet të zbatohet me kujdes dhe të shoqërohet me masa dhe politika përkatëse për risocializimin e personave të amnistuar pas lirimit të tyre, me qëllim që të parandalohen shkeljet e sërishme dhe pasojat e tjera negative.
- Urgjentisht është e nevojshme të bëhen reforma thelbësore të Komisioni për Anti-diskriminim, me qëllim që të sigurohet profesionalizëm më i madh, për kryerjen më me sukses të kompetencave të tij për mbrojtje të barabartë të të gjithë qytetarëve. Avokati i Popullit duhet të vazhdoj me përpjekjet dhe aktivitetet e tij në **luftën kundër diskriminimit** në kuadër të mandatit të tij. Ndryshimet dhe plotësimet e propozuara të Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi duhet ta fuqizojnë qasjen deri te drejtësia për viktimat e diskriminimit, në atë mënyrë që do t'i çlirojnë nga shpenzimet gjyqësore për hapjen e procedurave gjyqësore për mbrojtjen nga diskriminimi; fuqizimi i pavarësisë së Komisionit për Parandalimin e Diskriminimit; dhe përfshirja e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si bazë për diskriminim. Ekziston nevojë emergjente sa u përket rezultateve të hetimit të sulmuesve kundër qendrës LGBTI për mbështetjen e personave LGBTI. Në Ligjin e ri për ndihmë juridike falas duhet të inkorporohet përkufizim i gjerë dhe i qartë i çështjeve juridike për të cilat mund të jepet ndihmë juridike falas, si dhe të përfshihen të gjithë qytetarët të cilët kanë nevojë për ndihmë juridike dhe të lehtësohen kushtet të cilat qytetarët duhet t'i përmbushin në mënyrë që të kenë qasje deri te NJF.
- Shteti duhet ta sigurojë respektimin e **lirisë së tubimit** në atë mënyrë me të cilën nuk do të kufizohet as nga policia, as nga ndonjë grup i qytetarëve – kundërshtarë në rastet kur protestat janë publikuar në mënyrë përkatëse në përputhje me Ligjin për tubime publike. Hapja e procedurës penale kundër këtyre personave konsiderohet si paralajmërim për qytetarët e tjerë të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në protesta, në kundërshtim me nenin 21 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, nën i cili qytetarëve ua jep të drejtën e tubimit dhe mundësinë për të shprehur protestë publike pa paralajmërim paraprak ose leje të posaçme dhe realizimi i kësaj të drejtë mund kufizohet vetëm në kushte kur shpallet gjendje lufte ose gjendje e jashtëzakonshme, e që nuk ishte rast.

- Të shqiptohen masa përkatëse disiplinore kundër të gjithë nëpunësve policorë të cilët përdorin forcë të tepruar kundër pjesëmarrësve në protesta të qeta, si dhe kundër eprorëve të tyre.
- Reformat në **sektorin mediatik** duhet të zbatohen përmes ndryshimeve urgjente ligjore në konsultim me organizatat e shoqërisë civile. Është e domosdoshme që urgjentisht të ndryshoj Ligji për shërbime mediatike audio dhe audio-vizuale, me qëllim që të ndalohet reklamimi të cilin e paguan shteti, si dhe të sigurohet pavarësi dhe të evitohet ndikimi politik mbi trupin rregullator – Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audio-Vizuale. Radiodifuzerët rreptësisht duhet t'i monitorojnë parimet profesionale dhe të raportojnë në mënyrë objektive dhe pa paragjykime, duke i siguruar të gjitha qëndrimet relevante të cilat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Gazetarët duhet të kenë kujdes që as ata vet por as bashkëbiseduesit e tyre të mos përdorin gjuhë diskriminuese e cila nxit urrejtje, ofendime dhe shpifje. Shoqatat e gazetarëve dhe organizatat duhet t'i intensifikojnë përpjekjet e tyre, në mënyrë që të sigurojnë kushte për gazetarët dhe profesionistët e tjerë mediatik, me qëllim që pa frikë ose presion të mund t'i kryejnë detyrat e tyre profesionale. Është e domosdoshme të ndryshohet Ligji për përgjegjësi qytetare për shpifje, veçanërisht përkufizimet e tij (me qëllim që të harmonizohet me nenin 10 të KEDNJ).
- Sistemi i ri për ndjekjen e komunikimeve përmes AOT duhet të ketë masa të mjaftueshme mbrojtëse kundër përdorimit të saj arbitrar në dëm të privatësisë së qytetarëve. Që të arrihet kjo, organizatat e shoqërisë civile dhe Kuvendi duhet të kenë rol më të madh, me qëllim që në mënyrë efektive ta kontrollojnë funksionimin e AOT. **Monitorimi i komunikimeve**, si masë e posaçme hetuese, duhet të kufizohet në një kategori të caktuar të kundërvajtjeve dhe kushteve me të cilat masa e këtillë mund të shqiptohet gojarisht duhet të specifikohen në mënyrë më restriktive. Procesi i monitorimit duhet të kufizohet në kohë, ndërsa afatet e gjata, të parapara në aktet ekzistuese normative, duhet të rishikohen. Duhet të inkorporohet obligimi për trupin i cili e zbaton monitorimin për ta ndërprerë masën, pasi që të arrihen qëllimet për të cilat është shqiptuar masa. Njëherësh, ligji duhet të përcaktoj se personat e interesuar duhet të informohen për masat e posaçme hetimore të cilat zbatohen pasi që të njëjtat do të ndërpriten.
- Është e domosdoshme të ndryshohet praktika e paraburgimit të Prokurorisë Publike dhe të gjykatës, me qëllim që në mënyrë të njëtrajtshe të zbatohet Ligji për procedurë penale dhe neni 5 i KEDNJ. Gjithashtu, me qëllim që në mënyrë të barabartë dhe joselektive ta mbrojnë të drejtën e lirisë dhe sigurisë së të gjithë qytetarëve në vend, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të bartin përgjegjësi individuale nëse kanë qenë subjektiv dhe e kanë shkelur ligjin gjatë miratimit të vendimit për (mos) paraburgim.
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të bëjë përpjekje për zbulimin e kryerësve të kundërvajtjeve të konstatuara, si dhe për parandalimin e incidenteve të ngjashme në të ardhmen. Zgjidhjet ligjore të vendeve – anëtare të BE duhet të shqyrtohen me qëllim që të zgjerohet përfshirja e kundërvajtjeve që kanë të bëjnë me krime nga urrejtja, me qëllim që të përfshihen edhe baza të tjera për arbitraritet në këto kundërvajtje. Në mënyrë plotësuese duhet të sigurohet hetim në kohë dhe efikas për krimin nga urrejtja, duke i pasur parasysht motivet e veprimit arbitrar gjatë gjithë procedurës penale.
- Nevojitet një debat publik, gjithëpërfshirës dhe inkluziv, në të cilin do të përfshihej ekspertë dhe institucione akademike, si dhe shoqëria civile për **Ligjin për përdorimin e gjuhëve**. Miratimi i tij duhet të jetë rezultat i një procesi të plotë demokratik dhe transparent, në bazë të analizës thelbësore të implikimeve financiare të realizimit të tij mbi Buxhetin e Republikës së Maqedonisë. Përfundimisht, do të ishte mirë që ky ligj të miratohet pas pranimit të opinionëve dhe rekomandimeve relevante nga Komisioni i Venecias, me ç'rast do të mundësohej sanksionimi i tyre i plotë në tekstin e ligjit dhe do të pengoheshin situatat e mëtutjeshme kontroverze, të cilat në vend të promovimit të të drejtave të bashkësive do të çonin në tensione të mëtutjeshme të panevojshme ndëretnike dhe mosbesim tek qytetarët.
- Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personave duhet të ketë rol më të fuqishëm në mbrojtjen e qytetarëve dhe në mënyrë më aktive duhet të përfshihet në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale të qytetarëve. Domosdoshmërisht duhet të rishikohen nenet 255 dhe 263 të Ligjit për procedurë penale, në mënyrë që të mund të sigurohet që të dhënat e grumbulluara me ndjekjen e komunikimeve të shfrytëzohen vetëm për qëllimin për të cilin është lëshuar urdhri dhe të mos ruhen për një periudhë të gjatë të paarsyeshme kohore. Siguria e të dhënave të grumbulluara përmes ndjekjes së komunikimeve duhet të garantohet me ligj, si dhe shkatërrimi i tyre në rastet kur më nuk janë të nevojshme për qëllimin për të cilin janë grumbulluar. Ofruesit e shërbimeve elektronike të komunikimit duhet të ndërmarrin masa përkatëse teknike dhe organizative, me ç'rast qasje deri te të dhënat personale do të kenë vetëm personat e autorizuar, ndërkaq të dhënat të mbrohen nga format e paautorizuara dhe jolegale të përpunimit.

